**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

# V E N D I M

Nr.18, datë 28 .02. 2013

**PËR**

**" MIRATIMIN E LISTËS SË STRUKTURAVE QË PAJISEN ME LEJE PËRDORIMI SIPAS AKTIT NORMATIV DT.06.02.2013 PËR "PAJISJEN ME LEJE PËRDORIMI TË STRUKTURAVE TË NDËRTUARA ME SHKELJE TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËRPARA FILLIMIT ME EFEKTE TË PLOTA TË LIGJIT NR.10119, DATË 23.4.2009, "PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT", të ndryshuar"**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, neni 32 gërma "n", të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; neni 4 i Aktit Normativ datë 06.02.2013 për "Pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit" të ndryshuar", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e listës së strukturave që pajisen me leje përdorimi sipas Aktit Normativ datë 06.02.2013 për "Pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Të merren masa për lehtësimin e procedurave dhe listës së dokumentacionit, për t'u pajisur me leje përdorimi të strukturave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar në nenin 6 të Aktit Normativ datë 06.02.2013 për "Pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit".

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

**Niazi KOSOVRASTI**